



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 270/9 prot.

Tiranë, më 5.7.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 363, datë 1.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elizabeta Imeraj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 21.6.2021, është njoftuar vendimi nr. 363, datë 1.4.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elizabeta Imeraj, prokurore/Drejtuuese në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 21.6.2021, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Në vazhdim, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 29.6.2021 është depozituar akti “Shtesë (*Addendum*) në rekomandim për paraqitje ankimi”, i nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 21.6.2021 dhe 29.6.2021, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 363, datë 1.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ushtron detyrën e prokurores/Drejtueses në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Elizabeta Imeraj”² ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit znj. Elizabeta *** Imeraj³, ka referuar “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta *** Imeraj”. Me shkresën me nr. *** prot., datë ***.10.2019⁴, DSIK ka përditësuar informacionet dhe, në konfirmim të konstatimit fillestar, pas referimit të disa informacioneve nga autoritetet verifikuese, e ka lënë në vlerësimin e Komisionit vlerësimin e tyre.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁵ për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Elizabeta Imeraj.

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI me nr. ***/*** prot., datë ***.7.2018.

³ Shkresa e DSIK nr. *** prot., datë ***.10.2017.

⁴ Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.10.2019.

⁵ Raport i KLP-së nr. ***/*** prot., datë ***.4.2019.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë. Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit.*

1. Komisioni konstatoi disa problematika lidhur me pasuritë e ish-bashkëshortit në deklaratimet e bëra, por bazuar në praktikën e ndjekur nuk ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

2. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklaratime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe iu përgjigj saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë.

3. Mbështetur në Gjetjet mbi hetimin e kryer për vlerësimin e pasurive, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...] ⁶. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.* [...] ⁷. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLP, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për 5 (pesë) çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Nga denoncimet dhe gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni nuk konstatoi problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi profesionale të subjektit të*

⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 111-112 të vendimit.

⁷ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 112 të vendimit.

rivlerësimit [...]»⁸. Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 363, datë 1.4.2021, në bazë të nenit 59, pika 1, germa “c”, ka vendosur: “1.Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, prokurore/Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁹ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2¹⁰ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 21.6.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 363, datë 1.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Elizabeta Imeraj (bashkëlidhur këtij ankimi). Në datën 29.6.2021 është paraqitur pranë Institucionit të Komisionëve Publikë akti shtesë (Addendum) i Rekomandimit të datës 21.6.2021.

6. Në paragrafin 2, të pikës 5: “Përmbledhje e Rekomandimit”, Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit ka parashtruar qëndrimin se një vlerësim i duhur i fakteve dhe rishikimi i provave shkresore do ta çonte Kolegjin në ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

6.1 Në mënyrë të përmbledhur, objekti dhe çështjet e trajtuara në këtë Rekomandim lidhen me rezultatet e dala nga hetimi administrativ në raport me përfundimet e arritura nga Komisioni, më konkretisht për çështjet si vijon:

6.1.1 Për kriterin e pasurisë: (a) kredi bankare të subjektit të rivlerësimit në *** Bank; (b) pasuri e paluajtshme me adresë rruga: “***. ***. ***”, Tiranë, shpenzime për legalizimin e shtesës në këtë pasuri, si dhe çështjet lidhur me pasurinë e paluajtshme me adresë: rruga “*** ***”, Tiranë; (c) pasuri e paluajtshme, banesë në katin e tretë të godinës 5-katëshe, me adresë: rruga “*** ***”, Tiranë; (d) pasuri e paluajtshme: truall me sip. 2.500 m,² me adresë “***_*** ***”, Tiranë dhe çështjeve të lidhura me to.

6.1.2 Për kriterin e figurës, mbi cenimin e besimit të publikut lidhur me gjetjen mbi procedimet penale nga autoritetet gjyqësore italiane të shtetasve *** *** (ish-bashkëshortit) dhe *** *** (ish-kunatit), në vitin 2002.

6.1.3 Për kriterin e aftësive profesionale: mbi rrethanat dhe arsyet e sjelljes së subjektit të rivlerësimit si prokurore në dy procedime penale ndaj shtetasve ***. ***, **, ***, si dhe gjykimin e çështjes penale ndaj shtetasit kolumbian ***. ***. ***. **. (paraqitur me aktin shtesë (Addendum) e Rekomandimit.

⁸ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 112 të vendimit.

⁹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra [...] u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit [...].

¹⁰ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

6.1.4 Në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, Komisioni i përbërë nga tre vëzhgues ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në Rekomandimin e datës 21.6.2021, parashtron dhe çështje lidhur me: (i) fiktivitetin e divorcit të subjektit të rivlerësimit me z. *** ***; (ii) ndikimin e paligjshëm të subjektit të rivlerësimit tek njëri prej ish-vëzhguesve ndërkombëtarë dhe njëres prej Komisionerëve të Komisionit, që kishte qenë më herët pjesë e trupit gjykues, gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe (iii) mënyrën joprofesionale të sjelljes së subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 24.3.2021.

III. Gjetjet dhe opinionet e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të paraqitura gjatë hetimit administrativ të Komisionit

7. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “b” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në dosjen e Komisionit, gjatë hetimit administrativ që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Elizabeta Imeraj, janë administruar 7 (shtatë) Gjetje të ONM-së lidhur me tri kriteret e rivlerësimit, konkretisht:

- i.* Për kriterin e pasurisë është administruar 1 (një) Gjetje, (*i*) me nr. 208 prot., datë 12.2.2020;
- ii.* Për kriterin e aftësive profesionale është administruar 1 (një) Gjetje, (*ii*) me nr. 646 prot., datë 6.8.2020;
- iii.* Për kriterin e figurës janë administruar 2 (dy) Gjetje, (*iii*) me nr. 796 prot., datë 8.10.2020 dhe (*iv*) me nr. 850 prot., datë 21.10.2020;
- iv.* Për çështje të etikës dhe të integritetit janë administruar 3 (tre) Gjetje, (*v*) me nr.764 prot., datë 30.9.2020; (*vi*) me nr. 849 prot., datë 21.10.2020 dhe (*vii*) me nr. 1001 prot., datë 21.12.2020.
- v.* Gjithashtu, gjatë hetimit janë administruar dhe 6 (gjashtë) Opinione të ONM-së lidhur me tri kriteret e rivlerësimit konkretisht: (*i*) Opinion nr. 622 prot., datë 27.7.2020; (*ii*) Opinion nr. 624 prot., datë 28.7.2020; (*iii*) Opinion datë 6.8.2020; (*iv*) opinion nr. 680 prot., datë 24.8.2020; (*v*) Opinion nr. 691 prot., datë 1.9.2020 dhe (*vi*) Opinioni nr.733 prot., datë 16.9.2020.

IV. Vlerësimi i Komisionerit Publik

8. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

9. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

10. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni 4 i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

11. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet

e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

12. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 363/2021, bazuar dhe në Rekomandimin e nënshkruar nga një Komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, çmon se ai është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohen edhe në vijim, Komisioneri Publik i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si organi gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.

13. Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

14. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 363/2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

15. Komisioneri Publik konstaton se në arritjen e përfundimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është mbështetur në arsyetime dhe interpretime të gabuara lidhur me përmbajtjen dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe legjislacionit të posaçëm.

V. Analiza e shkaqeve të ankimit

V.A. Kontrolli i pasurisë

16. Si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të materializuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve që: (i) kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose (ii) nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ekzistencën e të ardhurave të ligjshme dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

17. Komisioneri Publik, ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit për këtë kriter, në rastin konkret konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, në kuptim dhe zbatim të nenit D, paragrafi 3, 5 të aneksit të Kushtetutës.

V.A.1 Deklarimi nga subjekti i rivlerësimit i regjimit pasuror për shkak të martesës

18. Nisur nga argumentimi ligjor që është përdorur nga ana e Komisionit në vendimin nr. 363/2021, për sa i takon kriterit të pasurisë, konstatohet se përfundimet e arritura për shumë nga çështjet që lidhen me rivlerësimin e këtij kriteri bazohen në natyrën juridike të regjimit pasuror të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj.

19. Rezulton se subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2004 dhe, në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave private periodike për vitet 2004-2016 (në vijim DV 20..) dhe në datën 29.1.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI Deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016.

19.1.1 Ndërkohë, në vendimin konkret, Komisioni arsyeton se: [...]Bazuar në kontratën nr. ***/**, datë ***.3.2007, ndër të tjera, është sanksionuar dhe bashkëlidhur dokumentacion provues sipas të cilit pasuritë: - banesa në “*** **”; - njësi me sip. 73 m² në rrugën “*** **”; - banesë me sip. 61 m², në *** **, Durrës; - pasuri tokë arë me sip. 1464, në***; dhe - e drejtë reale për pasurinë në rrugën “***. **”; janë pasuri apo të drejta të krijuara para lidhjes së martesës (kontrata është e datës ***.3.2007) dhe, si të tilla, ato qëndrojnë individuale të personit që i ka fituar apo i ka në pronësi.... Referuar situatës faktike në bazë të kontratës së regjimit pasuror martesor në raport me përcaktimet e Kodit të Familjes, rezulton se pasuritë e cituara në këtë kontratë (4 pasuri dhe një e drejtë reale), përbëjnë pasuri individuale të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit [...] ¹¹.

19.1.2 Referuar akteve në dosje, lidhur me deklarimin e regjimit pasuror martesor të subjektit të rivlerësimit rezulton se Komisioni, argumentimin e tij ligjor, nuk e bazon në një vlerësim të plotë të provave të administruara.

19.1.3 Nga shqyrtimi i Deklaratës së pasurisë (Shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, këtu e në vijim referuar si *D-Vett.*) dhe Deklaratave Periodike 2004-2016 (këtu e në vijim referuar DV-...), si të subjektit të rivlerësimit, ashtu edhe të personit të lidhur¹², nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjëherë një regjim i posaçëm pasuror martesor, detyrim ky, që rrjedh nga marrëdhëniet pronësore që rregullon një regjim i tillë, të cilat pasqyrohen në krijimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme objekt deklarimi, si nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, ashtu edhe nga ligji nr. 84/2016.

19.1.4 Rezulton se që prej fillimit të hetimit administrativ nga ana e Komisionit për efekt të procesit të rivlerësimit, hetim që ka filluar në datën 31.10.2018, dhe gjatë këtij hetimi administrativ nuk është deklaruar dhe as është pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit ekzistenca e një regjimi të tillë. Vetëm në datën 17.9.2020, në përgjigje të pyetjes së drejtuar nga Komisioni subjektit të rivlerësimit, lidhur me regjimin pasuror martesor që ka pasur ndër vite me ish-bashkëshortin, konstatohet të jetë pretenduar ekzistenca e regjimit të posaçëm pasuror martesor. Në përgjigje të pyetjes së parashtruar nga Komisioni¹³, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 17.9.2020, shprehet se: [...]... *ju bëj me dije se me ish-bashkëshortin i jemi nënshtruar regjimit pasuror të pasurive të ndara. Konform parashikimeve ligjore të kohës, para lidhjes së martesës me vullnet të lirë dhe të plotë, kemi diktuar dhe nënshkruar kontratën, e cila përcakton regjimin pasuror pas lidhjes së martesës (Ref. Kontratë “Regjimit pasuror*

¹¹ Referohuni vendimit , pika 7.28, faqet 16 e 17 të tij.

¹² Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga data ***.4.2007 deri më *** dhjetor 2019.

¹³ Lidhur me martesën tuaj me ish-bashkëshortin dhe regjimin pasuror që keni pasur ndër vite mund të deklaroni: - Çfarë regjimi pasuror martesor keni pasur? – Keni pasur një kontratë martesore që prej fillimit apo keni zgjedhur më pas gjatë martesës një regjim të pasurive të ndara? – Nëse keni pasur një regjim të përbashkët pasuror martesor (të bashkësisë ligjore), si i keni ndarë pasuritë pas zgjidhjes së martesës? A e keni filluar këtë proces? Mund të paraqisni prova për ndarjen e pasurisë dhe si është kryer ajo?

*paramartesor, regjim i pasurive të ndara”, nr. ***/**, datë ***.3.2007, të cilin e kam vënë edhe më parë¹⁴ në dispozicionin Tuaj) [...].*

19.1.5 Përkundër sa është pretenduar për ekzistencën e regjimit të posaçëm pasuror martesor, në referencë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në D-Vett., rezulton se vetë subjekti i rivlerësimit deklaroi si pasuri të paluajtshme, të luajtshme dhe të ardhura në “*bashkëpronësi*”, konkretisht: (i) të ardhura të përfituara nga shitja e një banese në Tropojë, pronë e familjes së bashkëshortit që nga viti 1985; (ii) pasuri të paluajtshme në rrugën “****. ****. ****”, Tiranë, blerë në vitin 2008, me burim krijimi kredi, në të cilën subjekti i rivlerësimit është dorëzues; (iii) legalizim shtesë banese në rrugën “****. ****. ****”, Tiranë, në emër të ish-bashkëshortit, me burim krijimi të ardhurat nga veprimtaria e bashkëshortit si noter dhe ekonomia familjare; (iv) të ardhura të përfituara nga vendimi gjyqësor i datës ***.1.2015 për shpërblim dëmi nga kompania *** për ish-bashkëshortin; (v) të ardhura të përfituara nga fondi i Emergjencave Civile sipas njoftimit të datës ***.12.2015 për ish-bashkëshortin; (vi) të ardhura nga qiratë e pasurive me adresë rruga: “**** ****” dhe rruga “****. ****. ****”, Tiranë, të përfituara nga ish-bashkëshorti; (vii) të ardhura nga dërgesat e realizuara nga vëllai i ish-bashkëshortit, në emër të këtij të fundit.

19.1.6 Gjithashtu, referuar përmbajtjes së Deklaratave Periodike, të plotësuara nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, rezulton se në DV-2007 (*dorëzuar më datë 31.3.2008*) subjekti i rivlerësimit deklaroi në bashkëpronësi me pjesë takuese “50%” pasurinë e paluajtshme: [...] *shtëpi banimi private pa numër ...në pronësi të bashkëshortit, kati i tretë* [...]. Po në DV-2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi: [...] *shlyerje totale kredie nga bashkëshorti për kredinë bankare marrë në *** në tetor 2006* [...]. Në DV-2008 (*dorëzuar më datë 25.3.2009*), subjekti i rivlerësimit deklaroi: [...] *blerje pasurie të paluajtshme në rrugën “**** ****”, për efekt dokumenti me shitës vëllain e bashkëshortit, dhe pasuria vazhdon të jetë e tij, për çmimin 3.900.000 lekë* [...]. Po në DV-2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi: [...] *blerje pasurie të paluajtshme në rrugën “****. ****. ****”, Tiranë, blerë nga bashkëshorti për çmimin 45.000 euro, regjistruar në emër të bashkëshortit, por në pronësi të përbashkët me vëllain, çmim i paguar bashkërisht, pjesa takuese 25%* [...]. Në DV-2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi: [...] *kontratë shkëmbimi me anë të cilës përfitohet pasuria truall 2500 m,² në rrugën “****_**** **** ****”, Tiranë* [...].

19.1.7 Sa më sipër trajtuar, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në D-Vett. dhe deklaratat periodike, pasuri të paluajtshme në bashkëpronësi, nga ku nuk dëshmohet se ka një regjim pasuror të pasurive të ndara, pasi një regjim pasuror i caktuar do të kishte efekte dhe pasoja në pasuritë e deklaruara. Referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, bazuar në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit, deklaratat periodike vjetore konsiderohen si provë në procesin e rivlerësimit¹⁵.

19.1.8 Për sa i përket argumentimit të Komisionit në vendimin konkret, lidhur me referencën në çështje dhe vendimmarrje të ngjashme, Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin e tij (JR)

¹⁴ Kopje e Kontratës, nr. ***/**, datë ***.3.2007, së referuar gjendet e depozituar për herë të parë me aktet që shoqërojnë përgjigjet e subjektit të rivlerësimit datë 25 shtator 2020.

¹⁵ Referohuni vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, (JR) nr. 6/2018, prg. 14; (JR) nr. 8/2018, prg. 43; (JR) nr. 12/2018, prg. 24.11; (JR) nr. 10/2018, prg. 67; (JR) nr. 5/2019, prg. 23 dhe (JR) nr. 19/2019, prg. 22.14.

nr.11, datë 31.3.2021, arsyeton se: [...] *16.1 Barazia në ligj dhe para ligjit, e trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme [...].* Ekzistenca e kushteve objektivisht të ndryshme, për subjekte rivlerësimit të ndryshëm në ato raste, është konstatuar në referencë të akteve të administruara, rrethanave juridike të provuara, përmbajtjes së Deklaratave Vjetore dhe Deklaratës “Vetting”.

V.A.2 Deklarimi i pasurive

20. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave periodike vjetore me Deklaratën “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, rezulton si vijon:

21. I. Pasuria e paluajtshme me nr. */**, ZK ***, me sipërfaqe 2.500 m², e ndodhur në rrugën “***-*** ***, ***, ***, Tiranë (në vijim referuar si “Pasuria truall 2500 m²”)**

21.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me këtë pasuri.

21.1.1 Në D-Vett. personi i lidhur, ish-bashkëshorti, ka deklaruar: [...] *pasuri e paluajtshme tokë, ndodhur tek ***-*** ***, Tiranë, në emër të *** ***, gjithsej 2.500 m², ndarë në 3 pjesë, konkretisht: sip. 2.290,30m²; sip.140 m²; sip.69,70 m². Përfutuar nga kontrata e shkëmbimit me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., e datës ***,11.2012. Burimi i krijimit: Tokë e ndodhur në ***, blerë në vitin 2006 nga të ardhurat e *** dhe *** ***. Pjesa takuese: Bashkëpronësi¹⁶[...].*

21.2 Në DV-2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Pasuri e ndodhur në adresën ***-*** ***, Tiranë, sipërfaqe 2.500 m². Burim krijimi: këmbimin me pasurinë e mëparshme të ndodhur në ***-Tiranë. Vlera: Pasuri e këmbyer. Pjesa takuese: Bashkëpronësi [...].*

21.2.1 Në DV-2012, nuk ka deklarim të personit të lidhur *** ***.

21.3 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se origjina e *Pasurisë truall 2500 m²* rrjedh nga Kontrata e shkëmbimit (pasuri të paluajtshme) me nr.*** rep. dhe nr. ***/** kol., datë ***.11.2012, me palë shtetasit *** *** dhe *** *** si bashkëpronarë të pasurisë me nr. ***/**, ZK *** ndodhur në Tiranë, te ***-*** ***, me sip. 2.500 m² dhe *** *** dhe *** *** si bashkëpronarë të pasurisë me nr. ***/** me sip.532 m², pasurisë me nr. ***/** me sip.532 m² dhe pasurisë me nr. ***/** me sip. 400m², ZK ***, ndodhur në ***, Tiranë, me objekt shkëmbimin e pasurive respektive pa kundërshtim.

21.4 Për pasuritë e paluajtshme me vendndodhje në ZK *** ***, Tiranë, në dosjen e Komisionit rezultojnë të administruara këto akte: (i) Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme, me nr. *** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.10.2006, me palë shitëse *****, ***, ***, dhe *** ***

¹⁶ Në të njëjtën deklaratë, personi i lidhur ka deklaruar: *Të drejta reale të krijuara si rezultat i marrëdhënies kontraktuale me ***.***.***. studio sipas kontratës së sipërmarrjes së datës ***.4.2014 me nr. ***/***. Këto të drejta nuk janë regjistruar akoma në regjistrat hipotekorë. Burimi i krijimit: Marrëdhënie kontraktuale për dhënie me përqindje ndërtimi të pasurisë tokë me sipërfaqe 2.360 m² ndodhur tek ***-*** ***, Tiranë. Kjo sipërfaqe toke është dhënë për zhvillim me përqindje ***.***.***. studio, në vlerën 37% të ndërtimit të përgjithshëm sipas lejes zhvillimore me nr. prot. ***, datë ***.10.2014, akorduar ***.***.***. studio me vendimin nr. ***/***, datë ***.7.2014, të Bashkisë Tiranë. Zotëron 37% të ndërtimit. Pjesa takuese: në bashkëpronësi.*

dhe palë blerëse *** ***, me objekt shitje të pasurisë me nr. ***/***, e llojit tokë arë, me sipërfaqe 532 m², ndodhur në ***, me çmim 1.750.000 lekë; (ii) Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.2.2007, me palë shitëse *** *** dhe palë blerëse *** ***, me objekt shitje të pasurisë me nr. ***/***, e llojit tokë arë, me sipërfaqe 532 m², ndodhur në ***, me çmim 1.700.000 lekë; (iii) Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.6.2007, me palë shitëse ***, ***, *** dhe *** *** dhe palë blerëse *** ***, me objekt shitje të pasurisë me nr. 158/9, e llojit tokë arë me sipërfaqe 400 m², ndodhur në ***, me çmim 1.000.000 lekë.

21.4.1 Në dosje, përveç kontratave sa më lart përshkruar, ndër të tjera, për *Pasurinë truall 2.500 m², e ndodhur në ZK ****, me adresë “***-*** *** **”, Tiranë, janë administruar këto akte: (i) Deklaratë e datës ***.7.2012¹⁷ (deklaratë për lidhjen e marrëveshjes kontraktuale të shërbimit) midis palëve z. *** *** dhe z. *** ***, në të cilën, ndër të tjera, deklarohet se: [...] ***. ***. ****. *njeh detyrimin prej 80.000 euro si shërbim i kryer nga ana e z. ***. ***... Ai merr përsipër ta konsiderojë hua të dhënë pa interes sasinë monetare prej 80.000 euro dhe garanton pagesën e saj në të holla apo dhe në ndonjë mënyrë tjetër...siç mund të jetë shkëmbimi apo dhe dhurimi...Në cilësinë e porositësit, z. ***.***. merr përsipër të përpilojë kontratë huaje duke njohur shumën deri në 80.000 euro si hua të marrë pa interes nga avokati ***.***. Gjithashtu z. ***. ***. merr përsipër të bëjë marrëveshje në rast mospagesës së shërbimit për avokatin për shkëmbimin e 2.500 m² tokë pasuri e paluajtshme, e ndodhur tek ***-*** *** *** me pasuritë e paluajtshme në pronësi të z. ***.***, të ndodhur në *** [...]; (ii) Kontratë huamarrje, me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.8.2012, me palë huadhënëse z. *** ***, dhe palë huamarrëse shtetasit *** *** dhe *** ***, me objekt marrje shume hua prej 80.000 euro¹⁸; (iii) Deklaratë noteriale¹⁹ me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.11.2012, ku z. *** *** deklaroi se, në datën ***.11.2012, ka marrë nga z. ***. *** shumën prej 80.000 euro; (iv) Kontratë sipërmarrje²⁰ me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.4.2014, me palë porositëse z. *** ***, në cilësinë e pronarit të pasurisë së paluajtshme nr. ***/***²¹ me sipërfaqe 2.360 m² dhe palë sipërmarrës shoqërinë “***.***.***. studio” sh.p.k., me objekt: bashkëpunimin dhe vënien në dispozicion nga pala pronare e truallit të sipërfaqes 2.360 m,² me qëllim ndërtimin e objektit “Godinë banimi dhe shërbimesh me 12 kate dhe me 1 kat nëntokë”.*

21.5. Komisioni, në rezultatet e hetimit, respektivisht të datave 16.10.2019 dhe 27.1.2021, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, lidhur më këto çështje:

21.5.1 *Mungesën e dokumentacionit justifikues provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruar për blerjen e pasurisë me sipërfaqe 400 m² në vitin 2007.*

21.5.2 *Mungesën e deklarimit në DV-2007 e në deklaratat vijuese, të pasurive tokë arë në ***.*

21.5.3 *Mungesën e justifikimit me dokumentacion provues të diferencës së çmimit të pasurive të paluajtshme të shkëmbyera.*

¹⁷ Vërtetimi nënshkrimi me nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë ***.7.2012, nga noteri publik *** ***, ***.

¹⁸ Në nenin 4, të kësaj kontrate parashikohet se huaja duhet të kthehet plotësisht brenda datës ***.12.2012, në rast se kjo shumë nuk do të kthehej në këtë afat, pala huamarrëse do të vinte si garanci pasurore për kthim e shumës apartamentin e banimit me sipërfaqe 147 m², pasuri me nr. ***/***+***-***, zona kadastrale ***, ndodhur në Rrugën *** ***, Tiranë.

¹⁹ Lidhur para noteres *** ***.

²⁰ Lidhur para noteres *** ***,***.

²¹ Nga aktet në dosje duket se është një nga pasuritë që rrjedh nga ndarja e pasurisë Truall 2500 m.²

21.5.4 Mungesën e ndonjë dokumenti për të provuar faturimin dhe deklarimin e shërbimeve ligjore (si avokat) në shumën prej 80.000 euro dhe pagesën e detyrimeve përkatëse pranë autoriteteve tatimore.

21.5.5 Mungesën e deklarimit në D-Vett. dhe deklaratat periodike të huadhënies prej 80.000 euro, dhënë shtetasit *** ** nga *** **.

21.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës²², në mënyrë të përmbledhur, është shprehur sa vijon:

21.6.1 [...] Për sa i përket pasurive: tokë arë në ***, të tria këto pasuri janë pasuri të krijuara përpara martese²³, përfshirë këtu dhe pasurinë²⁴ me sip. 400 m², fituar me kontratë të datës ***.6.2007, dhe si të tilla, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur as të drejtë pronësie dhe as detyrim për të deklaruar dhe justifikuar këto pasuri [...].

21.6.2 Për sa i përket mungesës së burimeve financiare, të konstatuara nga analiza e Komisionit për blerjen e pasurisë tokë arë me sip.400 m,² në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit parashtron se: [...] nisur nga fakti se këto pasuri provohen se janë pasuri të blera para martese, rrjedhimisht provohet dhe mundësia e personit të lidhur, për të mbuluar me burime të ligjshme pasuritë e blera deri në muajin prill 2007. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar dhe analizën financiare të kryer nga Komisioni, për investimet e personit të lidhur deri në momentin e martesës, duke pretenduar: (i) përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga qiraja për periudhën 2005-prill 2007, në shumën 1.360.000 lekë; (ii) përfshirjen në zërin të ardhura, edhe të shumave të dërguara nga z. *** ** në vitin 2006, në shumën 5.313.509 lekë [...].

21.6.3 Në lidhje me marrëdhëniet e personit të lidhur, si avokat me shtetasin *** **, dhe mosdeklarimin e huas prej 80.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ish-bashkëshorti ka kryer shërbime avokatie ndaj këtij shtetasi dhe, duke qenë se nuk kishte marrë asnjëherë shpërblim për shërbimet e kryera, me vullnet të lirë, palët e kanë vlerësuar këtë shërbim në vlerën 80.000 euro. Nëse kjo shumë nuk do të paguhej, si formë shpërblimi do të ndodhte shkëmbimi i pasurive të ndodhura në *** me atë të ndodhur tek ***-*** ** **, Tiranë. Ky detyrim u shua nga kontrata e shkëmbimit e vitit 2012, po me vullnet të lirë të palëve.

21.6.4 Në lidhje me mungesën e depozitimit dhe deklarimit në organet tatimore të dokumentacionit për të provuar faturimin e shërbimit të avokatisë në shumën 80.000 euro, nga ana e personit të lidhur, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ky shërbim nuk është faturuar ndonjëherë dhe, si i tillë, as nuk është deklaruar, duke qenë se kjo është një vlerë që palët e kanë çmuar midis tyre si një formë shpërblimi për shërbimet juridike të dhëna gjatë viteve. Duke qenë se detyrimet e palëve janë likuiduar me shkëmbimin e pasurive, si rezultat i mungesës së qarkullimeve monetare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, është pretenduar se nuk kanë pasur çfarë të deklarojnë në organet tatimore.

²² Referohuni përgjigjeve të subjektit të datave ***.11.2019 dhe ***.2.2021.

²³ Duke cituar kontratën e datës ***.3.2007, "Për regjimin e pasurive të ndara".

²⁴ Për të cilën, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka depozituar: "deklaratë për premtim shitje pasuri e paluajtshme tokë arë", të datës ***.10.2006, hartuar përpara avokatit *** **, në të cilën shtetasit *** dhe ***. *** deklarojnë se, sipas një marrëveshje verbale me shtetasit *** dhe *** **, kanë renë dakord t'i shesin 932 m² tokë për çmimin 2.750.000 lekë, këto pasuri janë shitur faktikisht dhe jemi likuiduar plotësisht me ta në momentin e nënshkrimit të deklaratës.

21.7 Komisioni, për pasurinë truall 2500 m² dhe pasuritë tokë arë në ***, ka ardhur në përfundimin se: [...] Nuk rezultoi që subjekti të këtë kryer veprime për këto pasuri apo të jetë përfituese e tyre. Sipërfaqet e tokës së ndodhura në ***, rezultojnë të jenë blerë nga ish-bashkëshorti, para martesës së subjektit, datë në të cilën sipas kontratës është bërë dhe likuidimi i sasisë monetare. Përfshirë edhe sipërfaqen e tokës prej 400 m², të blerë për çmimin 1.000.000 lekë, për të cilën deklarata e muajit tetor 2006, si dhe praktika e kryer në ish-ZVRPP-në Tiranë, për të sistemuar problematikat me këtë pasuri (filluar që në vitin 2006) krijojnë bindjen se çmimi i blerjes është paguar që në tetor 2006), para martesës së subjektit të rivlerësimit. Komisioni konstatoi disa pasaktësi lidhur me deklarin për këto pasuri, por veprimet janë kryer vetëm nga ish-bashkëshorti i subjektit si pronar i vetëm i këtyre pasurive të krijuara para martese dhe të përfshira në kontratën për regjimin pasuror të pasurive të ndara. Në vlerësimin e kësaj pasurie lidhur me burimin e ligjshëm dhe përgjegjësinë e subjektit, Komisioni i referohet dhe praktikës së Komisionit dhe Kolegjit. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri dhe subjekti ka bërë deklarin të saktë në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016²⁵[...].

21.8 Komisioneri Publik, referuar sa më lart, pas shqyrtimit të akteve të administruara në dosjen e Komisionit, bazuar në Rekomandimin e Komisionit prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, datë 21.6.2021²⁶, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, për sa argumentohet në vijim:

21.8.1 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me rrethanat mbi të cilat janë krijuar pasuritë e paluajtshme si në regjimin e pasurive të ndara, ashtu edhe në bashkëpronësinë faktike të personit të lidhur. z. *** *** me vëllezërit e tij, nuk gjen mbështetje në aktet e administruara në dosje, ashtu edhe në normat ligjore në fuqi të rregulluara nga legjislacioni civil dhe, më konkretisht, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 163²⁷ i tij. Nga aktet në dosje rezulton se, për fitimin e titullit të pronësisë së personit të lidhur dhe vetë subjektit të rivlerësimit, janë administruar disa kontrata shitje dhe një kontratë shkëmbimi²⁸, të cilat provojnë titullin e pronësisë në emër të tyre.

21.8.2 Ndryshe nga sa vjen në përfundime Komisioni, kur pretendon se nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të këtë kryer veprime për këto pasuri apo të jetë përfituese e tyre, është verifikuar se:

- subjekti i rivlerësimit, në DV- 2012, ka deklaruar bashkëpronësinë e saj në *Pasurinë truall 2500 m²*;
- subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronarit, ka nënshkruar Kontratën noteriale me nr. *** rep. dhe nr. ***/*** kol., datë ***.11.2012, për shkëmbimin e pasurisë ndodhur në ***, Tiranë, me pasurinë me sip. 2.500 m² truall ndodhur tek ***-*** *** ***, Tiranë;

²⁵ Referohuni pikës 12.16 të vendimit të Komisionit (faqe 29).

²⁶ Referohuni gërmës d) fq.6-8 të Rekomandimit.

²⁷ Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë.

²⁸ Kontratë shkëmbimi (pasuri të paluajtshme) nr. *** rep. dhe nr. ***/*** kol., datë ***.11.2012; Kontratë nr. *** rep. *** kol., datë ***.10.2006; Kontratë nr. *** rep. nr. *** kol., datë ***.2.2007; Kontratë nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.6.2007.

- në emër të subjektit të rivlerësimit është lëshuar Kartela e Pasurisë së Paluajtshme²⁹, për pasurinë nr. ***/***, e llojit truall, ZK ***, me sipërfaqe 2.500 m², me adresë ***-*** *** ***, Tiranë;

- subjekti i rivlerësimit, në datën ***.10.2006, ka përfituar një kredi në shumën prej 2.000.000 lekë nga ***, ku personi i lidhur, në cilësinë e të fejuarit të saj, ka dalë dorëzanës dhe hipotekues me pasuritë e tij.

21.8.3 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë truall 2.500 m², si në D-Vett., ashtu edhe në DV-2012, është deklaruar si burim shkëmbimi i pasurive të ndodhura në ***, Tiranë³⁰, ndërsa gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se si [...] *kompensim për shkëmbimin e pasurive të paluajtshme* [...] ³¹ ka shërbyer dhe shuma prej 80.000 euro, nga shërbimet e avokatisë të ofruara nga personi i lidhur.

21.8.3.1 Për pretendimin në lidhje me shumën prej 80.000 euro, megjithëse në mungesë të dokumentacionit mbështetës për shërbimet e kryera dhe faturimin e tyre, konstatohet se kjo shumë, nëse do të konsiderohej si pagesë shërbimi, do të duhej të faturohej dhe deklarohet në organet tatimore dhe për të, të paguheshin detyrimet në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim konsiderimin e tyre si të ligjshme, qoftë në formën e burimit, ashtu dhe të të ardhurave.

21.8.3.2 Për sa i përket burimit tjetër të pasurive, tokë arë, ndodhur në ***, Tiranë, ku përfshihet edhe pasuria nr. ***/***, me sip. 400 m², ZK ***, rezulton sa vijon:

- Kjo pasuri është fituar me kontratën e shitblerjes datë ***.6.2007, pas lidhjes së martesës të subjektit të rivlerësimit më datë ***.4.2007, dhe nuk rezulton e deklaruar në DV-2007. Përkundrejt pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se kjo pasuri është pjesë e pasurive të krijuara para martese, bazuar në Deklaratën e datës ***.10.2006, të shtetasve *** dhe *** ***, për premtim shitje pasurie të paluajtshme tokë arë 400 m², hartuar përpara avokatit *** ***, dorëzuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, vlerësohet se në raport me kontratën e shitblerjes të datës ***.6.2007, kjo deklaratë si akt i thjeshtë që i paraprin një akti noterial, nuk përbën provë dhe nuk mund të mbizotërojë mbi kontratën e shitjes, e cila ka fuqi të plotë provuese dhe ku në përmbajtjen e të cilës nuk gjendet referencë në shkresën e thjeshtë “Deklaratë” të datës ***.10.2006. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e të provuarit të të kundërtës së barrës së provës, mbi mbulimin me burime të ligjshme nga të ardhura të ligjshme të blerjes së truallit me sip. 400 m², në muajin qershor 2007.

- Nga ana tjetër, edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, mbi pagesën e çmimit 1.000.000 lekë, në datën ***.10.2006, përsëri nuk provohet mundësia financiare e z. *** ***, për mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të krijuara deri në prill 2007, përfshi këtu edhe pagesën e pasurisë tokë arë 400 m². Siç do të trajtohet në elementet e pasurisë *Godinë banimi 5 kate, në rrugën “*** ***”*, nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave nga qiraja e ambientit të ndodhur në rrugën “*** ***”, Tiranë, për periudhën 2005 – prill 2007. Referuar pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, për të përfshirë në analizën financiare edhe të

²⁹ Referohuni shkresës me nr. ***/***, datë ***.11.2018, të ZVRPP-së Tiranë.

³⁰ Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.139, datë 13.2.2008, “Për miratimin e çmimeve të trojeve ...”, vlera e pasurisë truall 2500m², ZK *** tek ***-*** *** ***, rezulton 71.647.500 lekë, ndërsa vlera e pasurisë 1464 m² tokë arë, ZK *** në *** rezulton 341.122 lekë.

³¹ Përgjigjet e subjektit të datës 30.5.2019, rubrika F, pika 4.

shumave të dërguara³² në emër të personit të lidhur, nga z. *** ***, konstatohet se në këto kushte, analiza financiare duhet të përfshijë gjithashtu si shpenzim edhe investimin e këtij të fundit për pasuritë në *Godinën 5 kate, në rrugën “**** **”, Tiranë*. Ky shpenzim do të sillte verifikimin e pamjaftueshmërisë financiare pasi investimi i pretenduar³³, rezulton më i lartë se vlera e shumave të dërguara.

21.9 Në përfundim për *pasurinë “Truall 2500 m²”* dhe pasuritë *“Tokë arë”* në ***, Tiranë konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

22. II. Pasuria e paluajtshme me nr. **+***, me sipërfaqe 66 m², dhe pasuria e paluajtshme me nr.***, me sipërfaqe 70.4 m², ZK ****, ndodhur në rrugën “*. *.***”, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament me sip. 66 m²” dhe “Shtesa e legalizuar 70.4m²”).**

22.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit deklaron: [...] *Apartament, pasuri e ndodhur në rrugën “*. *.***”, Tiranë*. Burimi i krijimit për apartamentin 66 m²: *kredi e marrë nga “****”, në shumën 100.000 euro, në të cilën jam dorëzënëse*. Vlera 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: *Në bashkëpronësi [...]*.

22.2 Në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaron: [...] *Legalizim shtesë banesë me sip. 70,4 m², në rrugën “****”*. Burim krijimi: *të ardhurat nga veprimtaria e bashkëshortit si noter dhe ekonomia familjare*. Vlera: *1.447.802 lekë dhe bono privatizimi 2.020.000 lekë*. Pjesa takuese: *Në bashkëpronësi [...]*.

22.3 Në D-Vett., personi i lidhur, ka deklaruar të njëjtat pasuri, me vlera dhe burime të njëjta dhe pjesë takuese bashkëpronësi në masën 50%.

22.4 Në DV-2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Blerje apartament banimi në Rr. “****”, Tiranë, blerje nga ***, regjistruar në emër të tij, por në pronësi të përbashkët me të vëllanë*. Çmimi i paguar bashkërisht. Vlera 45.000 euro. Pjesa takuese: 25%[...].

22.4.1 Po në DV-2008, në rubrikën *“Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”*, subjekti i rivlerësimit deklaron: [...] *Kredi e marrë nga *** në shumën 100.000 euro, në emër të ***, për blerjen e apartamentit tek “****” dhe tek “****” [...]*.

22.4.2 Në DV-2008, në Deklaratën e Interesave Private për personin e lidhur, është deklaruar [...] *Apartament rruga “****”, 4.2.2008, blerësi bashkëshorti*. Vlera: 45.000 euro. Pjesa takuese 25% [...].

22.5 Në DV-2015, personi i lidhur, ka deklaruar: [...] *Shtesa e legalizuar me sipërfaqe 70,4 m², në rrugën “****” Tiranë, sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë ***.8.2015*. Vlera: *1.447.802 lekë dhe bono privatizimi 2.020.000 lekë*. Pjesa takuese: 100% [...].

22.6 Në DV-2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me këtë pasuri.

22.7 Për pasuritë e paluajtshme (II) *Apartament 66 m² dhe Shtesë e legalizuar 70.4 m²*, në dosje, ndër të tjera, janë administruar aktet në vijim:

³² Edhe pse nga aktet e administruara rezultojn se të ardhurat e ligjshme të z.*** *** nuk mbulojnë shumat e dërguara.

³³ Në pronësi të *** *** rezultojnë 2 katë të kësaj godine, me vlerë rreth 8.000.000 lekë.

22.7.1 (i) Dokumenti me emërtimin: “Kontratë në dobi të personit të tretë, premtim për shitjen e banesës së ndodhur në rrugën “****” pall.***, sh.***, ap.***, kt.***, Tiranë,”³⁴ e datës ***.6.2006, me propozues *** dhe pranues propozimi z.***; (ii) Deklaratë e datës ***.1.2008, me deklaruese shtetasen ***, në prani dhe të shtetasve *** dhe ***, *** dhe Elizabeta Imeraj, e cila deklaroi se ka kanë rënë dakord për t’i shitur apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, shtetasit *** për shumën 150.000 euro, nga të cilat janë parapaguar 5.000 euro dhe pjesa tjetër do t’i jepet në momentin e përpilimit të kontratës së shitjes. Dokumenti ka për nënshkrim deklaruesen *** dhe z.***; (iii) Kontratë e kredisë bankare me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.1.2008, me palë kredidhënëse ***, palë kredimarrëse z.*** dhe dorëzënëse znj. Elizabeta Bajri (Imeraj), me objekt kredi në shumën 100.000 euro për blerje shtëpie; (iv) Kontratë hipotekimi me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.1.2008, me palë hipotekuese z.***, e pranishme në nënshkrim më cilësinë e bashkëshortes së hipotekuesit, e cila shpreh miratimin e saj për nënshkrimin e këtij akti, znj. Elizabeta Bajri (Imeraj). Në nenin 2 të kësaj kontrate, si garanci është pasuria apartament me nr.*** me sipërfaqe 73 m², në rrugën “****”, Tiranë; (v) Kontratë shitje pasuri e paluajtshme me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.1.2008, lidhur me ***, në cilësinë e shitësit, dhe ***, në cilësinë e blerësit, me objekt: pasuria apartament 66 m². Vlera e shitjes së pasurisë është përcaktuar 4.000.000 lekë; (vi) Dokumenti nxjerrje e llogarisë bankare të z.*** në ***, nga ku rezultoi se në llogarinë e tij është disbursuar kredia në shumën 100.000 euro dhe në datë 31.1.2008 është transferuar në llogari të znj.*** (jo të shitëses ***) shuma 90.000 euro, me përshkrimin “sa kaluar në llogari për blerje apartamenti për ***; (vii) Kontratë huamarrje, me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë *.2.2008, me palë huadhënëse *** dhe palë huamarrëse z.***, me objekt shumën 55.000 euro, me afat deri në ***.2.2009 (viii) Deklaratë noteriale të shtetasve *** dhe *** me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.04.2013, të cilët deklarojnë se z.*** e ka shlyer detyrimin në të holla që i ka marrë më datë ***.02.2008; (ix) Deklaratë noteriale me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.2.2016 e shtetasve *** dhe *** ***, të cilët deklarojnë se [...]në llogarinë tonë në datë ***.1.2008 na ka kaluar shuma 90.000 euro...nga të cilat 45.000 euro kanë qenë për banesën e shitur *** ***, nga shtetasja *** ***, dhe 45.000 euro kanë qenë për ne, duke qenë se shtetasi *** ***, na detyrohej që nga viti 2004[...]; (x) Deklaratën noteriale me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.2.2016 e shtetasës *** ***, e cila deklaroi se shuma e shitjes së apartamentit në rrugën “**** ***, i është dorëzuar nga e afërmja e saj shtetasja *** ***, (xi) Deklaratë noteriale nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.11.2019, e shtetasit *** ***, ku deklaroi se në vitin 2004 i ka marrë hua në shumën 55.000 euro, shtetasve *** dhe *** ***, (xii) Akt kualifikimi me nr.***, datë ***.7.2015, i ALUIZNI-t, Drejtoria Tirana 2, për objektin me sipërfaqe 70.4m², me destinacion socio-ekonomik, ndërtuar nga *** ***, të deklaruar me vetdeklarimin nr.***/****, datë ***.10.2006; (xiii) Kontratë e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore, me nr.***/**** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.8.2015, me palë shitëse ALUIZNI dhe palë blerëse z.*** ***, me objekt kalim në pronësi të parcelës ndërtimore me sip. 70,4 m²

³⁴ Vërtetim nënshkrimi i datës *.6.2006, me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., nga notere ***, ku nga përmbajtja e dokumentit rezultoi se znj.*** ka në pronësi një shtëpi banimi, me sipërfaqe 66 m², të ndodhur në rr.****, përfutur me kontratë shitblerje nr.*** rep., nr.*** kol., datë *.11.1998. Znj.*** deklaroi se një dhomë të kësaj banese ia ka lënë kundrejt pagesës av.***, me premtimin që ka për t’i shitur dhe gjithë banesën sapo të jetë gati për shitje. Gjithashtu, në kontratë parashikohet se në momentin më të parë që banesa e saj do të jetë e lirë për t’u shitur, është rënë dakord që këtë banesë ta blejë shtetasi ***, i cili ka edhe pjesën ballore të banesës time (ndërtim pa leje rreth 50 m²). Në lidhje me shtesën 50 m² av.*** ka të drejtën e aplikimit për legalizim. Një paradhënie me këtë shumë i është dhënë znj.*** që në momentin e përpilimit të kontratës. Prezent në lidhjen e kësaj kontrate kanë qenë dhe *** dhe ***.

me vlerë 1.447.802 lekë dhe bono privatizimi në vlerën 2.020.000 lekë; (xiv) Leje legalizimi në emër të z.*** ***, nr. ***, datë ***.8.2015, për objektin shtesë anësore 1 kat, në objektin ekzistues 5-katësh me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 70,4 m².

22.8 Komisioni, në rezultatet e hetimit të datave 16.10.2019 dhe 27.1.2021, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, ndër të tjera lidhur më këto çështje:

22.8.1 Mospërputhje në D-Vett. dhe DV-2008, lidhur me pronësinë, vlerën dhe burimin për blerjen e pasurisë apartament 66 m² ³⁵;

22.8.2 Ndryshimin e çmimit të parashikuar në kontratë në shumën 4.000.000 lekë, shumës së paguar nëpërmjet Bankës prej 90.000 euro, dhe deklaratës të administruar në dosjen e *** për vlerën 150.000 euro;

22.8.3 Mungesën e burimeve të ligjshme për likuidimin e kredisë 90.000 euro në të gjitha vitet si dhe për pagesën e tarifës së legalizimit të pasurisë shtesë e legalizuar 70.4 m², në vitin 2015;

22.8.4 Mosdeklarimin në D-Vett. dhe në deklarate peridike vjetore të huasë prej 55.000 euro, marrë nga z. *** ***;

22.8.5 Shlyerjen e huasë me anë të kredisë bankare në një kohë që kjo kredi është marrë dhe i është transferuar zj. *** *** 1 ditë para marrjes së huasë;

22.8.6 Mosdeklarim në D-Vett. dhe në deklarate peridike vjetore të huasë prej 45.000 euro³⁶, e pretenduar e shlyer nga kredia e marrë prej saj (subjektit);

22.8.7 Mospërputhje midis deklarimit në DV-2008 dhe deklarimeve gjatë hetimit administrativ për qëllimin e marrjes dhe përdorimit të kredisë bankare prej 90.000 euro.

22.9 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ dhe në përgjigje të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur, është shprehur se:

22.9.1 Për pasurinë e ndodhur në rrugën “**** ***” me sip.66 m² [...]ish-bashkëshorti ka gëzuar një të drejtë reale mbi të, qysh para lidhjes së martesës. Përmes kontratës së datës ***.3.2007, rikonfirmohet se pavarësisht se cili do të jetë momenti i formalizimit të kontratës së shit-blerjes, kjo pasuri dhe shtesa e vetëdeklaruar për legalizim nga ish-bashkëshorti (2006), do të vijojnë të mbeten pasuri të tij personale/vetjake. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është kredia e marrë në bankë[...].

22.9.2 Në lidhje me mundësinë e likuidimit të legalizimit të shtesës në datën ***.08.2015, nga ish-bashkëshorti, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se rezulton se ka patur mundësi për krijimin e saj, duke rezultuar në këtë datë edhe një balancë pozitive në përfundim.

22.9.3 Për transferimin e shumës 90.000 euro tek znj. *** ***, subjekti i rivlerësimit parashtron se shuma i është kaluar në llogari kësaj të fundit, sipas kërkesës së bërë nga shitësi i pasurisë apartament 66 m², znj. *** ***, si dhe për shlyerjen e një huaje marrë më parë pa kontratë dhe pa interes nga vëllai i personit të lidhur³⁷.

³⁵ Në D-Vett., 4.000.000 lekë, ndërsa në DV- 2008 si vlerë ka deklaruar 45.000 euro; mospërputhje në pjesën në bashkëpronësi, në D-Vett. është deklaruar në bashkëpronësinë me bashkëshortin 50%, ndërsa në DV-2008 ka deklaruar 25% në bashkëpronësi me të vëllain; mospërputhje lidhur me burimin e krijimit, në DV-2008 si burim deklarohen të ardhurat e bashkëshortit të subjektit dhe vëllait të tij, ndërsa në deklaratën vetting burimi i deklaruar është një kredi prej 100.000 euro, hua nga ***.

³⁶ Hua e pretenduar e marrë nga kunati *** *** në vitin 2004 nga *** ***.

³⁷ Sipas deklaratës noteriale të administruar në dosje huamarrës rezulton *** ***, ndërkohë në përgjigjet e datës 30.5.2019, subjekti deklaroi se: vlera prej 45.000 euro është marrë hua nga vëllai i bashkëshortit tim para lidhjes së martesës sime në vitin 2004. Qëllimi i marrjes së huasë ka qënë për shpenzime të ndryshme që lidhen me banesën në rr. “**** ***”, pronar i së cilës në atë periudhë rezulton z. *** ***.

22.9.4 Lidhur me mospërputhjet e çmimit të pasurisë apartament 66 m², subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se çmimi është ai i shënuar në kontratën e shitjes, si i vetmi akt juridik sipas parashikimeve të Kodit Civil Shqiptar, çmim në vlerën 4.000.000 lekë. Shuma e përmendur në deklaratë, prej 150.000 euro, sipas subjektit të rivlerësimit nuk është bërë ndonjëherë si pagesë, pasi deklarata nuk prodhon efekte juridike. Deklarata mes palëve e datës ****.01.2008*, përbën një akt përmes të cilës palët zotoheshin se në të ardhmen do të kryenin një shitblerje, por kjo deklaratë nuk ka patur efekte juridike pasi edhe termat e vendosur në të ishin vetëm eventuale, ka pretenduar subjekti i rivlerësimit.

22.10 Komisioni për pasuritë (II) *Apartment 66 m² dhe pasurinë Shtesë e legalizuar 70,4 m²*, ka argumentuar se³⁸: [...] *në lidhje me pasurinë apartament me sip. 66 m², në pronësi të shtetasit *** ***, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, që vjen në analogji dhe me dy deklaratat noteriale të datës ****.2.2016* (të hartuar para plotësimit dhe depozitimit të deklaratës Vetting nga subjekti). Si rrjedhim, rezultoi se burim i krijimit të saj ka qenë kredia bankare e përfituar nga ish-bashkëshorti në vlerën prej 100.000 euro ... subjekti dhe personi i lidhur kanë bërë deklarime të plota dhe të sakta duke vënë në dispozicion çdo deklaratë apo dhe akte ligjore të kryera para noterit. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është kredia e marrë në bankë në vitin 2008. Komisioni nuk konstatoi probleme në lidhje me këtë pasuri ... nga analiza financiare përfundimtare në lidhje me këtë pasuri rezulton se subjekti dhe ish-bashkëshorti kishin mundësi financiare për legalizimin e shtesës së kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës[...]*

22.11 Komisioneri Publik, referuar sa më lart, pas shqyrtimit të akteve të administruara në dosjen e Komisionit, bazuar në rekomandimin e Komisionit prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtar të ONM-së, datë 21.6.2021³⁹, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, për sa argumentohet në vijim:

22.11.1 Subjekti i rivlerësimit, ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pronësinë mbi këtë pasuri. Rezulton se në D.-Vett. subjekti i rivlerësimit deklaroi vetëm bashkëpronësi, ndërsa në DV-2008 deklaroi bashkëpronësi në pjesë takuese 25%;

22.11.2 Subjekti i rivlerësimit, ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e pasurisë. Rezulton se në D.-Vett. vlera e apartamentit 66 m² deklarohet 4.000.000 lekë, ndërsa në DV-2008 deklarohet 45.000 euro, ndërkohë që transferta e kryer në favor të **** **** për blerje apartamenti është në vlerën 90.000 euro;

22.11.3 Subjekti i rivlerësimit, ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për burimin e krijimit, pasi në D.-Vett. deklarohet si burim kredia bankare pranë *****, ndërsa në DV-2008 deklarohet, çmimi i paguar bashkarisht me vëllain e personit të lidhur.

22.11.4 Dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, mbi këto pasuri dhe deklarimet e subjektit në D.-Vett., në Deklaratat Periodike Vjetore, dhe gjatë hetimit administrativ, referojnë vlera të ndryshme, papajtueshmëri të cilat çojnë në mospërputhje lidhur me vlerën e çmimit real të blerjes së këtyre pasurive.

22.11.5 Subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë provuar të kundërtën e barrës së provës, lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar ndër vite, për shlyerjen e kësteve të kredisë dhe pagesën e legalizimit në vitin 2015. Kjo për shkak se lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme, të të ardhurave të

³⁸ Referohuni pikave 7.13 (faqe 13) dhe 7.30, 7.33 (faqe 18) të vendimit të Komisionit.

³⁹ Referohuni gjërës d) fq.6-8 e Rekomandimit.

ligjshme të realizuara nga qiradhënia e pasurive të ndodhura në rrugën “****” dhe rrugën “****” ndër vite, rezulton se Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me anë të shkresës nr.****/**** prot., datë ****.11.2019, të depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, konfirmon se personi i lidhur është regjistruar si individ për deklaratën e DIVA, me datë regjistrimi në sistemin @Cats 09.01.2018 dhe me datë fillimi transaksioni 01.01.2011. Bazuar në përmbajtjen e kësaj shkresë, rezulton se detyrimet tatimore lidhur me të ardhurat e realizuara nga marrëdhëniet e qirasë për disa prej kontratave, janë deklaruar pranë organeve tatimore për efekt të shlyerjes së detyrimeve fiskale, pas dorëzimit të D-Vett., dhe si të tilla, bazuar në jurisprudencën vijuese të Kolegjit⁴⁰, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke ndikuar analizën financiare të viteve përkatëse dhe mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e kryera.

22.11.6 Lidhur me marrëdhëniet e huave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, (i) hua marrë nga **** **** në shumën 45.000 euro (deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit të Komisionit, si një nga destinacionet e kredisë së marrë në vitin 2008) dhe (ii) hua marrë **** **** në shumën 55.000 euro, nga aktet e adminstruara në dosje nuk rezulton të jenë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike vjetore apo atë Vetting në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar⁴¹, duke mbetur dhe kontradiktore mes tyre.

22.12 Në përfundim, për pasurinë (II) *Apartament 66 m² dhe Shtesë e legalizuar 70,4 m²*, vlerësohet se, si pasojë e deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit gjatë plotësimit të Deklaratës Vetting, Deklarimeve Periodike Vjetore, deklarimeve përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe qëndrimi gjatë hetimit administrativ, në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këto pasuri të paluajtshme, krijojnë pamundësinë për të verifikuar se cilat ndër deklaratimet e subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me krijimin e pasurive në fjalë dhe, për rrjedhojë, pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të tyre, qëndrim ky i mbajtur edhe në jurisprudencën e Kolegjit vendim (JR) nr.11, datë 3.7.2020.

22.13 Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet se është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

23. III. Pasuria e paluajtshme me nr.** ****, ZK **** apartament me sip.73 m² ndodhur në rrugën “**** ****”, Tiranë (në vijim referuar si *Apartament 73 m²*).**

23.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me këtë pasuri.

23.1.1 Në D-Vett., personi i lidhur, **** **** ka deklaruar [...]pasuri e ndodhur në rr.”**** ****”, Tiranë, në emër të **** ****, por në pronësi të përbashkët të familjarëve të mi, **** ****, etj. Burimi i krijimit: të ardhura nga veprimtaria e punësimit. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: bashkëpronësi[...].

23.2 Në DV-2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar [...]Blerje apartamenti në rrugën “**** ****”, Tiranë, në datë ****.1.2008, blerje për efekt dokumentash, shitësi është vëllai i

⁴⁰ Kolegji ka trajtuar në disa vendime çështje lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore me vonesë për efekt të procesit të rivlerësimit, si psh vendim (JR) nr.7/2019, vendim (JR) nr.8/2019, vendim (JR) nr.19/2019, vendim (JR) nr.5/2020.

⁴¹ Nuk është deklaruar huamarrja dhe kthimi huasë në shumën 55.000 euro si dhe destinacioni i kredisë i pretenduar të ketë shërbyer pjesërisht për shlyerjen e huasë në shumën 45.000 euro.

*bashkëshortit dhe pasuria vazhdon të jetë e tij (4.1.2008). Vlera 3.900.000 lekë⁴². Pjesa takuese: pa përshkrim[...]. Në të njëjtin formular në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar [...]kredi e marrë nga *** në emër të *** *** për blerje apartamenti tek rr. “*** ***” dhe tek rr. “*** ***”, sipas deklarimit të bërë (shuma 100.000 euro)[...].*

23.3 Në DV-2008, në emër të personit të lidhur deklarohet e njëjta pasuri.

23.4 Lidhur me pasurinë *Apartament 73 m²*, në dosjen e Komisionit ndër të tjera janë administruar, aktet si vijon:

23.4.1 (i) Kontratë shitblerje me nr.*** rep. nr.*** kol., datë ***.12.1996, me palë shitëse bashkëpronar *** dhe palë blerëse *** ***, me objekt shitjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 73 m² ndodhur në rrugën “*** ***”, Tiranë, në shumën 1.750.000 lekë; (ii) Kontratë shitblerje me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë ***.1.2008, me palë shitëse z. *** dhe *** *** dhe palë blerëse z. *** ***, me objekt apartament me sipërfaqe 73 m², rruga “*** ***” Tiranë, për çmimin 500.000 lekë.

23.5 Komisioni në rezultatet e hetimit të datës 29.11.2019 dhe 27.1.2021, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, ndër të tjera lidhur me këto çështje:

23.5.1 *Mungesë burimesh për blerjen e këtij apartamenti pasi sipas Kontratës së Blerjes, kjo pasuri është blerë më ***/01/2008 dhe duket se të ardhurat e siguruara nga punësimi deri në atë datë nuk janë të mjaftueshme për blerjen e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursimet në cash në fund të vitit 2007, në DV-2007;*

23.5.2 *Mospërputhje midis çmimit të blerjes të deklaruar në D-vett., 500.000 lekë, në DV-2008 deklaruar 3.900.000 lekë, si dhe vlera e pasurisë së paluajtshme, e vlerësuar në 146.000 euro (ose 18.000.000 lekë), bazuar në raportin e vlerësimit të datës 28 dhjetor 2007.*

23.5.3 *Mospërputhje mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie midis D-Vett ku burimi deklarohet “nga punësimi” dhe në DV-2008, ku burimi deklarohet “kredi nga ***”.*

23.6 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur është shprehur se [...] *kjo pasuri është krijuar nga familja e bashkëshortit në vitin 1996 dhe se nuk ka asnjë lloj kontributi dhe asnjë lidhje me këtë pasuri. Bashkëshorti ka vendosur si kolateral një apartament të ndodhur në rrugën “*** ***”, i cili i është shitur nga vëllai i tij, shtetasi *** *** në vlerën 500.000 lekë. Kjo vlerë për shkak të lidhjeve të posaçme, është likuiduar gjatë vitit 2008...Çmimi është ai i përcaktuar në kontratë 500.000 lekë[...]*

23.7 Komisioni për pasurinë (III) *Apartament 73 m²* arrin në përfundimin se⁴³ [...] *Subjekti nuk ka asnjë të drejtë reale mbi këtë pasuri dhe as ka realizuar përfitime prej saj. Deklarimet e dhëna në lidhje me këtë pasuri janë gjendur të sakta. Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri dhe subjekti ka bërë deklarim të saktë në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

23.8 Komisioneri Publik, referuar sa më lart, pas shqyrtimit të akteve të administruara në dosjen e Komisionit, bazuar në rekomandimin e Komisionit prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtar të ONM-së datë 21.6.2021⁴⁴, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, përsa argumentohet në vijim:

⁴² Deklarohet në lekë të vjetra.

⁴³ Referohuni pikës 11.9 të vendimit (fq.24).

⁴⁴ Referohuni gërmës d) fq.6-8 e rekomandimit.

23.8.1 Nga aktet në dosje, rezultoi se kjo pasuri është fituar me kontratë shitblerje me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë ***.1.2008, pas lidhjes së martesës të subjektit të rivlerësimit me personin e lidhur. Subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me (i) pamjaftueshmërinë e konstatuar për blerjen e kësaj pasurie në datë 04.01.2008, me vlerën e pasqyruar në kontratë, përsa kohë që nga verifikimi i Deklarimeve Periodike Vjetore nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, të kenë deklaruar kursime në *cash* në deklaratimet paraardhëse; (ii) kredia bankare pranë ***, e deklaruar në DV-2008 nga subjekti si burim krijimi për këtë pasuri, rezultoi e marrë në datën 31.01.2008, pas blerjes së pasurisë më datë 4.1.2008; (iii) pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni, i referohet çmimit të blerjes të përcaktuar në kontratë prej 500.000 lekë, çmim ky që rezultoi më i ulët se vetë çmimi i blerjes së kësaj pasurie 12 vite më parë, 1.750.000 lekë apo vlerësimit të kryer, referuar raportit të vlerësimit në dosjen e bankës *** prej 146.000 euro.

23.9 Në përfundim, për pasurinë (III) *Apartament 73 m²* deklarimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet se është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

24. IV. Kredi në emër të subjektit të rivlerësimit pranë * marrë në vitin 2006.**

24.1 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar [...] *kredi e marrë në *** me qëllim përdorimi për rregullimin e shtëpisë dhe blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake, në shumën 20 milionë lekë (të vjetra)*[...]. Në rubrikën të dhëna konfidenciale, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar [...] *një kredi e marrë tek *** në vitin 2006, kredi e marrë për rregullimin e shtëpisë tek prindërit*[...].

24.2 Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar [...] *kredi bankare e marrë në tetor 2006, në shumën 20 milionë lekë (të vjetra), me pagesë mujore 180.000 lekë (të vjetra) në muaj. Maj 2007, shlyerje totale kredie nga bashkëshorti*[...].

24.2.1 Lidhur me këtë veprim financiar, në dosjen e Komisionit ndër të tjera janë administruar aktet si vijon:

(i) Kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol, datë ***.10.2006, lidhur nëpërmjet *** si palë kredidhënëse, subjektit të rivlerësimit në cilësinë e kredimarrëses dhe shtetasit *** ***, në cilësinë e dorëzanësit, është aprovuar lëvrimi i një shume kredie prej 2.000.000 lekë në favor të kredimarrëses, me qëllim *“ndërtimin e një shtëpie”*. Sipas kushteve të kontratës së kredisë, në nenin 9 të saj, sigurimi i kredisë, parashikohet se: *kredimarrësi dhe dorëzanësi kundrejt kredisë dhënë nga banka, sigurojnë këtë të fundit me anë të garancisë përfaqësuar nga hipotekimi i pasurive:*

- *“Truall” me sip. 332 m² e ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***/***... me adresë *** Tiranë, në pronësi të z.*** ***.*
- *“Apartament + Ambiente ndihmëse” me sip. 61 m² i rregjistruar në rregjistrin hipotekor me nr. *** datë ***.1.2006...ndodhur në ***, Durrës, në pronësi të z.*** ***.*

(ii) Kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.10.2006, me hipotekues z.*** *** dhe subjektin e rivlerësimit në cilësinë e të fejuarës. Neni 2.1 i saj, parashikon se: *kredimarrësi dhe dorëzanësi garantojnë se me marrjen e titullit të pronësisë për objektin i cili*

po ndërtohet në pikën 2.1 (i referohet truallit 332 m²) do të bëjë bllokimin në favor të ***, brenda shtator 2007, duke parashikuar dhe penalitete në rast vonese.

24.2.2 Nga verifikimi i lëvizjeve në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë *** rezulton se në datën ***.10.2006 është disbursuar kredia, e cila është tërhequr në cash në po të njëjtën datë nga vetë ajo në shumën 1.920.000 lekë.

24.2.3 Në datën ***.05.2007 është depozituar në *** nga subjekti, shuma 2.079.000 lekë, me përshkrimin “sa derdhur për mbyllje kredie”.

24.3 Komisioni, në rezultatet e hetimit të datave 16.10.2019 dhe 27.1.2021 i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera lidhur me këto çështje:

(i) *Mospërputhje në lidhje me destinacionin e kësaj kredie midis deklarimit të subjektit në DV 2006 dhe qëllimit të kredisë të parashikuar në kontratën me Bankën;*

(ii) *Nga kontrata e hipotekimit rezulton se ndërtesa 5 katëshe në pronësi të bashkëshortit të subjektit nuk ka qenë e përfunduar, ndryshe nga sa deklarohet në deklaratën vetting;*

(iii) *Gjendja cash në shtëpi (shuma e kredisë së tërhequr) nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006;*

(iv) *Duket se ka mospërputhje midis deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2007 që kredia është shlyer plotësisht nga ish bashkëshorti i saj dhe shpjegimeve të saj gjatë hetimit;*

(v) *Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shlyerjen e parakohshme të kredisë dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës për një diferencë negative prej – 1.235.725 lekë.*

24.4 Subjekti në përgjigje të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar: (i) lidhur me mospërputhjet e qëllimit të kredisë [...]...*Kredia është përfituar në datën *** tetor 2006, me qëllim konstruksion banese dhe blerjen e pajisjeve shtëpiake...qëllimi i marrjes së kredisë është shpjeguar detajisht në DV-2006[...];* (ii) lidhur me konstatimet mbi ndërtesën lënë kolateral [...] të gjitha aktet zyrtare të lëshuara nga institucionet përkatëse konfirmojnë se kjo banesë është ndërtuar dhe përfunduar në vitin 2006 [...] (iii) lidhur me pamundësinë financiare të konstatuar, [...] *Shuma e marrë kredi është deklaruar rregullisht në deklaratën periodike të vitit 2006 në rubrikën e detyrimeve financiare, por nuk është deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë, e kjo ka ardhur për shkak të perceptimit që unë kam pasur për këtë kredi, pasi kjo shumë monetare lidhej me huan/detyrimin dhe jo me gjendjen e krijuar për shkak kursimi... E gjithë kredia e marrë nga *** për këtë periudhë nuk është përdorur dhe është kthyer përsëri mbrapsht në Bankë [...].*

24.5 Komisioni⁴⁵, përgjatë rivlerësimit të këtyre veprimeve financiare, ka arritur në përfundimin se [...] *nuk u konstatua shpenzim i kryer i vlerës së kredisë për ndërtim shtëpie në vitin 2006 dhe 2007. Komisioni i konsideroi bindëse deklaratimet e subjektit për mospërdorimin e kredisë në vitin 2006, duke pasur parasysh se kredia e përfituar është deklaruar edhe në deklaratën periodike për vitin 2006 nga subjekti. Vlera e kredisë së papërdorur në vitin 2006, u konsiderua si burim kryesor për shlyerjen e saj në vitin 2007, së bashku me të ardhurat e subjektit dhe ish-bashkëshortit. Mosdeklarimin e gjendjes cash në DV-në e vitit 2006, Komisioni e konsideron si paqartësi të subjektit për plotësimin e kësaj DV-je, pasi subjekti e ka deklaruar si të ardhur kredinë e përfituar në këtë vit, duke u pasqyruar kështu*

⁴⁵ Referohuni pikës 4.13 të vendimit (fq.9).

edhe gjendja e saj deri në datën 31.12.2006. Komisioni në vendimmarrje mori në konsideratë edhe faktin se vetëm me ndryshimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, në vitin 2014, u përfshi deklarimi për “gjendje cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lek ose në valutë të huaj [...]”.

24.6 Komisioneri Publik, referuar sa më lart, pas shqyrtimit të akteve të administruara në dosjen e Komisionit, bazuar në rekomandimin e Komisionit prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtar të ONM-së datë 21.6.2021⁴⁶, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, përta argumentohet në vijim:

24.6.1 Përkundrejt arsyetimit të Komisionit mbi faktin se [...]detyrimi i subjektit të rivlerësimit mbi deklarimin e “gjendjes cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse në depozitë...” ka lindur vetëm me ndryshimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, në vitin 2014, [...] nga verifikimi i rubrikës “deklarimi i interesave private, pasuri të paluajtshme/të luajtshme”, rezulton se në Deklaratën e Interesave Periodikë Vjetorë për vitin 2006, në faqen 3 të saj, evidentohet detyrimi për të deklaruar [...]...vlerën e likuiditeteve, gjendjen në cash, në llogari rrjedhëse [...].

24.6.2 Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë provuar të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për shlyerjen e kredisë në maj 2007, për sa kohë që nuk rezulton të ketë deklaruar kursime cash apo posedim të likuiditeteve cash në DV-2006. Ky interpretim ligjor i referohet dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit në lidhje me deklarimin e kursimeve cash nga ana e subjekteve të rivlerësimit.⁴⁷

24.7 Ky burim, nuk konstatohet as i deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007⁴⁸, akt i cili bazuar në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit, konsiderohet si provë në këtë proces.

24.8 Në përfundim, për kredinë (IV) e datës **.10.2006, prej 2.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

25. V. Pasuria e paluajtshme “Godinë banimi 5-kate, ndodhur në rrugën “** **”, ZK ***, Tiranë.**

25.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar mbi këtë pasuri.

25.2 Në D-Vett. personi i lidhur z.*** ***, ka deklaruar [...]Shtëpi banimi e ndodhur në rr. “**** **”, Tiranë (kjo banesë është e ndarë në 5 kate), kati i tretë është regjistruar në emrin tim dhe është në pronësi dhe në përdorim nga ana ime. Burimi i krijimit të ardhurat e mia dhe familjarëve të mi, të krijuara në vite.... Vlera për blerjen e truallit 3.300.000 lekë. Vlera për ndërtim 4.000.000 lekë (për pesë kate), vlera për legalizim 127.745 lekë (për pesë kate). Pjesa takuese 100% [...].

25.3 Po në D-Vett, në rubrikën “Deklarimi i Pasurive” në numrat rendor 2, 3, 4 dhe 5 personi i lidhur, ka deklaruar[...] (i) kati i parë, regjistruar në emër të *** ***, në pronësi të vëllait

⁴⁶ Referohuni gjermës d) fq.6-8 e Rekomandimit.

⁴⁷ Kolegji i Posaçëm i Apelit ka trajtuar në disa vendime lidhur me deklarimin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të prg. 27; (JR) nr. 19/2019 në prg. 84; (JR) nr. 20/2019 në prg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në prg. 31.

⁴⁸ Në DV 2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për shlyerjen e kredisë: shlyerje totale kredie nga bashkëshorti.

*** **⁴⁹. Pjesa takuese 0%, (ii) kati i dytë, regjistruar në emër të *** ***, në pronësi të *** ***, i cili banon aktualisht me familjarët e tij aty⁵⁰. Pjesa takuese 0%, (iii) kati i katërt, regjistruar në emër të *** ***, në pronësi të vëllait *** ***, banon aktualisht me nënën *** **⁵¹. Pjesa takuese 0%. (iv) kati i pestë, regjistruar në emër të *** ***, në pronësi të vëllait *** **⁵². Pjesa takuese 0%.[...].

25.4 Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar[...] *Shtëpi banimi private pa numër rruga "*** **", *** **, Tiranë (e pahirtekuar) në pronësi të bashkëshortit, kati i tretë. Vlera 40 milion lekë të vjetra. Pjesa takuese 50%[...].*

25.5 Në DV-2007 në emër të personit të lidhur z. *** **, deklarohet [...] *Një shtëpi banimi private pa numër kati i tretë e paregjistruar. Vlera 40 milion lekë të vjetra e ndërtuar vetë. Pjesa takuese 30 %[...].*

25.6 Lidhur me këtë pasuri në dosje të Komisionit, ndër të tjera janë administruar aktet si vijon:

25.6.1 (i) Kontratë shitje me nr.*** rep., dhe nr.*** kol., datë ***.4.2006, me palë shitëse ***.e ***.*** dhe palë blerëse z.*** **, me objekt shitje truall me sip 332 m2, pasuria me nr. ***/***, blerë për çmimin 3.300.000 lekë; (ii) Formular vetëdeklarimi nr. *** prot., datë ***.8.2006 për legalizimin e objektit "shtëpi banimi" me deklarues *** **, viti i ndërtimit 3.3.2006, nr i kateve 5; (iii) Leje legalizimi në emër të z.*** **, me nr.*** **, datë ****.03.2011, për objektin godinë banimi 5-kate; (iv) Formulari i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale me nr.***/*** prot., datë ***.11.2010, ku vlera e investimit është llogaritur në total në shumën 22.349.070 lekë dhe vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë në shumën 111.745 lekë, e cila rezulton e paguar nga z.*** ** në nëntor 2010; (v) Certifikatë për vërtetim pronësie me nr.*** datë lëshimi ***.9.2011 për pasurinë me nr.*** në emër të *** ***; (vi) Certifikatë për vërtetim pronësie me nr.*** datë lëshimi ***.9.2011 për pasurinë me nr.*** në emër të *** ***; (vii) Certifikatë për vërtetim pronësie me nr.*** datë lëshimi ***.9.2011 për pasurinë me nr.*** në emër të *** ***; (viii) Certifikatë për vërtetim pronësie me nr.*** datë lëshimi ***.9.2011 për pasurinë me nr.*** në emër të *** ***; (ix) Certifikatë për vërtetim pronësie me nr.*** datë lëshimi ***.9.2011 për pasurinë me nr.*** në emër të *** ***; (x) Deklaratë e z.*** ** e datës ***.1.2011 në të cilën deklarohet se objekti i vetëdeklarimit [...]godinë banimi ndodhur në njësinë bashkiake nr.***" është ndërtuar në pronësinë e tij, konkretisht në parcelën me sip.332 m2... shtetasi *** ** është njohur dhe ka kryer të gjitha pagesat e detyrueshme për efekt legalizimi, ka shlyer të gjitha detyrimet[...]; (xi) Katër kontrata dhurimi të datës 8.2.2017 me palë të njëjtë dhuruese z. *** ** dhe palë pranuese të dhurimit (1) shtetasin *** ** për pasurinë *** shtetasin *** ** për pasuritë *** dhe *** dhe (3) shtetasin *** ** për pasurinë ***.

25.7 Komisioni në rezultatet e hetimit të datës 16.10.2019, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, ndër të tjera lidhur me këto çështje:

25.7.1 *Nuk provohet me dokumentacion ligjor ndërtimi i banesës në vitin 2006;*

25.7.2 *Nuk provohet me dokumentacion ligjor kostoja e ndërtimit të kësaj pasurie (Godinë banimi 5-kate) në shumën 4.000.000 lekë;*

⁴⁹ Burimi i krijimit të ardhurat e fituara gjatë viteve nga ***, ***, *** dhe *** **.

⁵⁰ Burimi i krijimit të ardhurat e fituara gjatë viteve nga ***, *** dhe *** **.

⁵¹ Burimi i krijimit; të ardhurat e fituara gjatë viteve nga ***, *** dhe *** **.

⁵² Burimi i krijimit; të ardhurat e fituara gjatë viteve nga ***, *** dhe *** **.

25.7.3 Bazuar në kostot e ndërtimit të përcaktuara nga EKB personi i lidhur *** *** nuk ka patur mundësi të krijojë pasuritë e krijuara para martesë për një diferencë negative në vlerën – 20.576.598 lekë.

25.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës në mënyrë të përmbledhur është shprehur sa vijon:

25.8.1 Lidhur me kohën e ndërtimit, subjekti i rivlerësimit përgjigjet se [...] nga formulari i vetëdeklarimit për legalizim plotësuar dhe dorëzuar nga *** *** në datën ***.8.2006, është e përcaktuar se ndërtesa mbi truallin përkatës është ndërtuar në mars 2006 ... Gjithë financimi dhe ndërtimi i shtëpisë të ndodhur në rr. “*** ***” është realizuar përpara datës 26.4.2007 [...].

25.8.2 Lidhur me koston e ndërtimit, subjekti përgjigjet se [...] deklarimi në lidhje me shtëpinë e ndodhur në katin e tretë të një ndërtese pesë katëshe, në të cilën jeton pas lidhjes së martesës dhe deri aktualisht së bashku me bashkëshortin dhe fëmijët ka një vlerë të përputhshme plotësisht me koston e ndërtimit të saj sipas standartit të EKB [...].

25.9 Lidhur me burimin e krijimit, subjekti përgjigjet se [...] shtëpia e ndodhur në katin e tretë të ndërtesës 5-katëshe rezulton në emër të bashkëshortit të saj, ajo përbën pasuri të krijuar para martesë për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë të drejtë pronësie mbi të, duke mos patur kështu asnjë detyrim për të justifikuar burimin e krijimit të saj [...].

25.10 Komisioni në rezultatet e hetimit të datës 27.1.2021, pasi ka konsideruar si investim të personit të lidhur vetëm shumën prej 4.000.000 lekë, për ndërtimin e katit të tretë të godinës 5 katëshe, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës pasi ka konstatuar pamjaftueshmëri financiare të z.*** në shumën – 5.510.528 lekë⁵³ për të mbuluar investimet e kryera deri në prill 2007.

25.11 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se [...] duke qenë se kati i tretë i banesës është përdorur prej saj për banim për shkak martesë, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe ligjshmërisë, në rang moral më shumë se në rang ligjor, ka bërë një hetim të thelluar për të justifikuar mundësinë e ish-bashkëshortit për të krijuar këtë pasuri të paluajtshme, në të cilën ka jetuar gjatë martesës....Duke qenë se detyrimi i saj, proporcionalisht qëndron vetëm për këtë banesë të cilën e ka përdorur për banim si derivat i martesës, rezulton se ish-bashkëshorti ka patur mundësi dukshëm për të krijuar këtë pasuri në vitin 2006 [...].

25.12 Lidhur me analizën financiare të kryer për pasuritë e personit të lidhur para martesë, deri në Prill 2007, subjekti ka kërkuar të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme edhe (i) të ardhurat nga qiraja e pasurisë apartament me sip. 73 m² ndodhur në rrugën “*** ***”, Tiranë për periudhën 2005 - prill 2007 në shumën 1.360.000 lekë, si dhe (ii) shumat e dërguara nga vëllai i personit të lidhur në vitin 2006 në shumën totale 5.313.509 lekë.

25.13 Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni për pasurinë “Godinë banimi 5-kate në rr. “*** ***”, Tiranë”, arsyeton si vijon⁵⁴:

[...]Në përfundim të hetimit të kryer mbi këtë pasuri duke mbajtur në konsideratë edhe arsyetimin në pikën 7.28 të këtij vendimi⁵⁵, si edhe faktet e rezultuara të provuara në lidhje me këtë pasuri, Komisioni gjeti të sakta deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe nuk konstatoi problematika në lidhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016[...].

⁵³ Referuhuni relacionit mbi rezultatet e hetimit datë 27.1.2021, fq. 27-28.

⁵⁴ Referohuni pikës 10.18 të vendimit (fq.23).

⁵⁵ Konkluzioni i Komisionit për regjimin e pasurive të ndara sipas kontratës paramartesore paraqitur nga subjekti.

25.14 Komisioneri Publik, referuar sa më lart, pas shqyrtimit të akteve të administruara në dosjen e Komisionit, bazuar në rekomandimin e Komisionit prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtar të ONM-së datë 21.6.2021⁵⁶, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, përsa argumentohet në vijim:

25.14.1 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me rrethanat mbi të cilat është krijuar kjo pasuri e paluajtshme, në bashkëpronësi faktike të personit të lidhur z.*** *** me vëllezërit e tij, nisur nga përmbajtja e akteve të administruara në dosjen e Komisionit, nuk gjen referencë në normat ligjore në fuqi të rregulluara nga legjislacioni civil dhe më konkretisht Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 163⁵⁷ të tij.

25.14.2 Nga aktet në dosje rezulton se për titullin e pronësisë të personit të lidhur z. *** *** janë administruar: (i) kontrate shitje pasurie e paluajtshme e datës ***.4.2006 për pasurinë truall me sip 332 m² si dhe (ii) leje legalizimi nr.*** datë ***.3.2011, të cilat provojnë titullin e pronësisë në emër të personit të lidhur dhe, janë sipas mënyrës së fitimit me ligj të pronësisë e rregulluar nga Kodi Civil.

25.14.3 Bazuar në sa më sipër, konstatohet se nisur nga përmbajtja e gjithë dokumentacionit ligjor të administruar gjatë hetimit administrativ, rezulton se si pasuria truall, ashtu edhe ndërtimi i ngritur mbi këtë truall deri në momentin e plotësimit të D-Vett., kanë patur për titullar të pronësisë personin e lidhur.

25.14.4 Nga aktet në dosje rezulton se pasuria “truall” me sip.332 m² e ndodhur në *** , Tiranë ka shërbyer si garanci pasurore për marrjen e një kredie nga subjekti i rivlerësimit në shumën 2.000.000 lekë në datë ***.10.2006 (*para lidhjes së martesës ligjore datë ***.4.2007*), ku personi i lidhur, në cilësinë e të fejuarit të subjektit, ka dalë dorëzanës dhe hipotekues me pasuritë e poseduara prej tij, element i cili tregon për interesa pasurore të përbashkët të subjektit të rivlerësimit dhe z.*** ***. Referuar kontratës së kredisë, qëllimi i financimit është për ndërtimin e një shtëpie. Nga ana tjetër, nga informacioni i përcjellë nga ALUIZNI⁵⁸ janë përcjellë edhe fotografi të objektit godinë banimi 5 - kate nga ku duket sikur godina në fjalë, në kohën e aplikimit për kredi, ka qenë e papërfunduar plotësisht⁵⁹.

25.14.5 Bazuar në sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë Godinë banimi 5 katëshe.

25.14.6 Nga ana tjetër, edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar mundësinë e ish-bashkëshortit vetëm për katin e tretë të banesës 5-katëshe, përsëri rezulton pamjaftueshmëri financiare në shumën -5.510.528 lekë, për mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të krijuara deri në prill 2007 nga z.*** ***, pasi:

i. Sa i takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në analizën financiare, shumën 5.313.509⁶⁰ lekë të dërguar nga z.*** *** në llogarinë e z.*** ***, analiza duket se duhet të përfshijë gjithashtu si shpenzim edhe investimin e këtij të fundit për dy katet e banimit në të njëjtën godinë, që aktualisht rezultojnë në pronësi të tij. Përfshirja e këtyre zërave në analizë do të rezultonte përsëri në pamjaftueshmëri të burimeve financiare, pasi vlera e investimit është më e lartë se vlera e dërgesave.

⁵⁶ Referohuni gërmës d) fq.6-, të Rekomandimit.

⁵⁷ “Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë”

⁵⁸ Me shkresën e nr.*** prot., datë ***.10.2018.

⁵⁹ Nga fotografitë bashkangjitur kësaj shkrese konstatohet se godina është karabina e mbyllur me tulla, e pabanueshme. Subjekti në DV-2007 ka deklaruar si adresë të plotë ku banon “Apartament në rrugën *** ***, Tiranë”.

⁶⁰ Nga aktet e administruara për të provuar të ardhurat e ligjshme të z. *** *** për periudhën 2004-2006, rezulton se këto të ardhura nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës në Angli dhe shumat e dërguara *** ***.

ii. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga qiraja e ambientit të ndodhur në rrugën “**** ****”, për vitet 2005-prill 2007, nga aktet e administruara në dosje rezulton se, përveç se pasuria gjatë këtyre viteve, ka qenë në pronësi të vëllait të tij (*** ***), nga përgjigjet e organeve tatimore⁶¹, *konfirmohet se këto të ardhura janë përfshirë nga z. **** **** në të ardhurat individuale të vetëdeklaruarat të vitit 2011 dhe ky i fundit është regjistruar si individ për deklaratën e DIVA me datë regjistrimi në sistemin @Cats 9.1.2018 dhe me datë fillimi transaksioni 1.1.2011.*

Sa më sipër vlerësohet se detyrimet tatimore lidhur me të ardhurat e realizuara nga kjo marrëdhënie qiraje, janë deklaruar pranë organeve tatimore, pas dorëzimit të deklaratës vetting dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

25.15 Në përfundim për pasurinë (V) *Godinë banimi 5 kate*, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

V.B. Për kontrollin e figurës

26. Komisioneri Publik, pas shqyrtimit të akteve të administruara në dosje, arsytimit të vendimit konkret të Komisionit dhe përmbajtjes së Rekomandimit të Komisionit prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtar të ONM-së, rezulton se këta të fundit i qëndrojnë përmbajtjes së 2 (dy) Gjetjeve që janë paraqitur nga ONM gjatë hetimit administrativ të Komisionit për vlerësimin e kriterit të figurës.

27. Në Gjetjen e ONM, nr.796, datë 08.10.2020, në rubrikën “Finding”, në referencë të përmbajtjes së germës “b”, pika 3, Neni B i Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr.84/2016, ONM parashtron [...] *Vëzhguesi Ndërkombëtar paraqet këtë Gjetje në lidhje me një vendim të Dhomës Penale të Gjykatës së distriktit Romë (Itali) të datës ***.12.2020, në të cilin, mes të tjerash, u dënuan **** **** (tani ish bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe ende jetues së bashku me të) dhe **** **** (ish kunati i subjektit të rivlerësimit, vëlla i ish bashkëshortit dhe jetues në të njëjtën godinë me subjektin e rivlerësimit). Bazuar në vendimin e gjykatës, bashkëlidhur kësaj Gjetje, dy personat e lartpërmendur janë dënuar me 8 vjet burgim dhe një gjobë prej 55.000 Euro për përfshirjen e tyre në trafikimin e qënieve njerëzore dhe prostitucion. Në kuadër të vlerësimit të subjektit të rivlerësimit, ky informacion është absolutisht relevant dhe duhet të jetë pjesë e dosjes së çështjes [...].*

28. Në vijim të përmbajtjes së Gjetjes së datës 08.10.2020, ONM ka paraqitur një tjetër Gjetje. Në Gjetjen e ONM-së nr. 850 prot., datë 21.10.2020, në pikën 3 të saj “Conclusion”, në referencë të përmbajtjes së germës “b”, pika 3, Neni B i Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr.84/2016, ONM ka arritur në këtë konkluzion [...] *Duke marrë në konsideratë sa më lart, Vëzhguesi Ndërkombëtar beson se, në dritën e standarteve ndërkombëtare të përmendura në këtë dokument dhe provave në dispozicion, subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas kuptimit të Nenit Dh, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës. Në rast se subjekti i rivlerësimit arrin të provojë padijeninë e saj për përfshirjen e personave në krimin e*

